



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës  
Press Council of Kosovo  
Savet Štampe Kosova

**6 nëntor 2017, Prishtinë,  
Ref:21.09.2017\571-2017**

**Opinion i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj  
ankesës së Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31 tetor 2017, shqyrtoi ankesën e Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot lidhur me artikullin "Pazari i majmë për stacionin lë në hije autobusët" të datë 12.09.2017, dhe nxori këtë

O P I N I O N

- Ankesa miratohet

## A R S Y E T I M I

Në ankesë kundërshtohen prononcimet e analistëve të cilët gazeta Kosova Sot i paraqet si fakte, sipas të cilave "Shpend Ahmeti ka bërë pazare me Devollët dhe Baton Haxhiun qysh në fillim të mandatit të tij kriminal për dhënien e një milion metrave katrorë, ose 15 hektar te stacioni i autobusëve mafio-oligarkëve Devolli".

Devolli quhet "bandë serbe" dhe se Shpend Ahmeti është i kapur nga Devollët.

Bordi i KMSHK, pasi shqyrtoi artikullin në fjalë dhe ankesën vendosi se gazeta Kosova Sot ka mbështetur shkrimin e saj vetëm me prononcimet e analistëve të vet, pa fakte konkrete. Sipas Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës, lajmi duhet të mbështetet me fakte.

Gjithashtu, gazeta nuk ka mbështetur këto akuza duke mos kërkuar prononcime edhe nga organet shtetërore. Në këtë mënyrë është shkelur Kreu II (Raportimi i së vërtetës).

Në këtë rast, gazeta nuk ka kërkuar as pronocimin e Devolli Group ose të ndonjë subjekti të pavarur lidhur me këto çështje, me çka ka shkelur Kreun IV (E drejta për t'u përgjigjur).

Opinionimi u nxor me shumicën e votave të të gjithë të pranishmëve.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMSHK vendosi si në dispozitiv të këtij opinionimi.

**Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës**